

## **Vendim nr. 24 datë 06.02.2023**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                  |           |
|------------------|-----------|
| Elsa Toska,      | Kryesuese |
| Ilir Toska,      | Anëtar    |
| Gent Ibrahim, i, | Anëtar    |

në datën 06.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (Sh) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **SHKËLQIM DUSHKU**

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 103, datë 25.07.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese dhe urdhërimi për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.**

**Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2021-2086(187), datë 15.12.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 1300, datë 30.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**Lënia në fuqi e vendimit nr. 12236, datë 12.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, pika 1, 11, pikat 1 dhe 2, 15, 17, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pika 1 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë palë e paditur në procesin gjyqësor me objekt pavlefshmërinë absolute të testamentit nr. 5, datë 23.08.1998, të lëshuar nga mamaja e tij, e ndjera B.D., dhe deklarin e pavlefshëm të dëshmisë së trashëgimisë testamentare, sipas vendimit gjyqësor nr. 2238, datë 22.05.2003.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12236, datë 12.12.2012, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim paditësit.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1300, datë 30.05.2013, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 12236, datë 12.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimin e kërkesëpadisë dhe deklarin si absolutisht të pavlefshëm të testamentit nr. 5, datë 23.08.1998 të së ndjerës B.D., duke deklaruar si të pavlefshëm dëshminë e trashëgimisë testamentare sipas vendimit gjyqësor nr. 2338, datë 22.05.2003. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen B.D., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë fëmijët e saj [...]”*. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2021-2086 (187), datë 15.12.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1300, datë 30.05.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuesi, në datën 24.06.2022, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e tij.

5. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 103, datë 25.07.2022, ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, pasi kërkuesi, për kundërshtimin e vendimit nr. 00-2021-2086 (187), datë 15.12.2021, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, nuk legjitimohej *ratione temporis*.

6. Në datën 27.12.2022 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 103, datë 25.07.2022 të Kolegjit të Gjykatës, duke kërkuar sërish shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2021-2086(187), datë 15.12.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. 1300, datë 30.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

### II

## **Pretendimet e kërkuessit**

7. Kërkuessi ka pretenduar se Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 103, datë 25.07.2022, ka cenuar sigurinë juridike, pasi komunikimi nëpërmjet internetit nuk mund të jetë një detyrim ligjor deri në nivel kushtetues, për t'u çmuar si mjet detyrues për individin në përgjithësi dhe për njerëzit në moshë të madhe në veçanti, të cilët kanë vështirësi në përdorimin e tij. Gjithashtu, kërkuessi ka pretenduar përsëri edhe shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit, me argumentin se ato bien ndesh me parimet kushtetuese të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, të ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës, të mosdiskriminimit, si dhe me të drejtën e aksesit.

## **III**

### **Vlerësimi i Kolegjit**

8. Kërkuessi, në kërkesën drejtuar Gjykatës, ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 103, datë 25.07.2022 të saj, për ankimin kushtetues individual të paraqitur më parë prej tij dhe, për rrjedhojë, të shqyrtimin e kushtetutshmërisë të vendimeve nr. 00-2021-2086(187), datë 15.12.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. 1300, datë 30.05.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi Gjykata e Lartë e ka shpallur vendimin e kundërshtuar të paarsyetuar dhe atij i është komunikuar në datën 09.06.2022, ndërsa kërkesa në Gjykatë është paraqitur prej tij në datën 24.06.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

9. Kushtetuta në nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, të saj, shprehet qartësisht në lidhje me forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, edhe në ligjin nr. 8577/2000 është parashikuar se vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim (*shih nenet 72/7 dhe 76/1 të tij*).

10. Nga ana tjetër, ligji nr. 8577/2000, në nenin 80, pika 1, të tij, ka rregulluar kompetencën e Gjykatës për të saktësuar dhe plotësuar vendimin e saj. Kështu, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Gjithashtu, sipas nenit 71/c, pikat 3 dhe 4 të po këtij ligji, nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës për rihapje të procesit gjyqësor. Kërkesa për rihapje të procesit në Gjykatë paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Ajo duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, si dhe

kërkimet konkrete. Kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e aktit.

11. Kolegji, në vështrim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të mësipërme, si dhe rrethanave faktike, vëren se kërkuesi nuk gjendet në asnjë nga situatat e lartpërmendura, ndaj dhe, për rrjedhojë, vendimi nr.103 i Kolegjit nuk mund të plotësohet, saktësohet dhe as të shfuqizohet.

12. Në përfundim, për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesa e paraqitur është haptazi e pabazuar dhe nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.